



Kumtesë për shtyp No.18/55
PËR PUBLIKIM TË MENJËHERSHËM
15 Shkurt, 2018

Fondi Monetar Ndërkombëtar
Uashington, D.C. 20431 SHBA

Deklaratë e Zëvendës drejtorit Menaxhues të FMN-së, Tao Zhang, në përmbyllje të vizitës së tij në Kosovë

- Vendit i duhet një rritje e fortë dhe e qëndrueshme për të zënë hapin me Evropën.
- Ulja e papunësisë, veçanërisht tek të rinjtë, është detyrë urgjente për autoritetet e vendit.
- Diskutimet kishin në fokus politikat për të mbështetur zhvillimin e sektorit privat dhe nxitur investime, si dhe për të siguruar stabilitet fiskal dhe financiar.

Z. Tao Zhang, Zëvendës drejtor Menaxhues i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), lëshoi këtë deklaratë, sot në Prishtinë, në përmbyllje të vizitës së tij në Kosovë.

“Ishte kënaqësi e vërtetë të vizitohet Kosovën për herë të parë. Pata privilegjin të takohem me Kryeministrin Ramush Haradinaj, Kryetarin e Kuvendit Kadri Veseli, Ministrin e Financave Bedri Hamza, si dhe ushtruesin e detyrës së Guvernatorit të Bankës Qendrore Fehmi Mehmeti, ku patëm diskutime tejet frytdhënëse lidhur me reformat ekonomike dhe prioritetet e politikave të Kosovës. Gjithashtu, pata rastin të vizitohet qytetin e Prizrenit për të përjetuar një pjesë të trashëgimisë mbresëlënëse kulturore të Kosovës, si dhe u takova me studentë të Universitetit të Prishtinës për t’i dëgjuar sfidat dhe aspiratat e tyre për të ardhmen.

“Kosova ka qenë shembull i suksesshëm i një shteti të paskonfliktit që arriti ta zhvillojë ekonominë e saj duke zbatuar reforma të rëndësishme. Në takimet e mia i kam inkurajuar autoritetet që ta vazhdojnë këtë rrugëtim, meqë Kosova do të ketë nevojë për rritje të fuqishme, të qëndrueshme dhe përfshirëse për të ulur hendekun e lartë të të ardhurave me pjesën tjetër të Evropës. Kjo përfshin uljen e papunësisë, veçanërisht tek të rinjtë, si dhe varësinë në remitanca. Në këtë drejtim, theksova nevojën për të përshpejtuar reformat e tilla – veçanërisht në fushat e arsimit, qeverisjes, shëndetësisë, infrastrukturës dhe qasjes në financa, për të përmirësuar aftësinë konkurruese, tërhequr investime të huaja direkte, si dhe për të nxitur zhvillimin e sektorit privat.

“Politikat e kujdesshme fiskale dhe stabiliteti makroekonomik janë kushtet bazë për një rritje më të fortë dhe unë përgëzova qeverinë kosovare për disiplinën fiskale dhe stabilitetin financiar të viteve të fundit. Në këtë drejtim, reformat dhe frenimi i rritjeve në shpenzimet e patargetuara të përfitimeve sociale si dhe të pagave publike do të ndihmonte në krijimin e hapësirës së nevojshme fiskale për shpenzime prioritare në arsim, shëndetësi dhe

infrastrukturë brenda kufijve të rregullës fiskale, e cila vazhdon të jetë adekuate. Forcimi i administratës tatimore do të ndihmojë në luftimin e informalitetit dhe në sigurimin e një mjedisi miqësor për investime.

“Dua të përsëris mbështetjen e fuqishme të FMN-së për Kosovën dhe mirëpres të vazhdojmë partneritetin tonë me qeverinë në këtë program të rëndësishëm të reformave, përmes këshillave të politikave dhe asistencës teknike. Së fundi, dëshiroj të falënderoj qeverinë dhe popullin e Kosovës për një mikpritje shumë të ngrohtë”.